



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 486/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), dega në Drenas për shkak të pa rregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se me datë 03.11.2013 në ora 13:14 kanë vërejtur se në Qendrën e Votimit (QV) 0315E në shkollën e mesme "Fehmi Lladrovci" është vendosur poster i PDK-së me nr.99 dhe pas vëzhgimit të përfaqësuesve tanë gjatë fotografimit sekretari i shkollës "Isak Ismajli" ju ka bere vërejtje por kjo pano është vendosurë qe nga dita e djeshme. Parashtruesi i ankesës pretendon, se është shkelur neni 36 pika a) neni 36 Veprimet e ndaluara para procesit të votimit neni 36.1 dhe pika a) dhe b), thuhet në pretendimet e ankuesit .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesë nuk qëndrojnë, ngase parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar asnjë provë që mund të identifikohet shkelja e supozuar. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante , andaj në kuptim te nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 486/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*